Liberté • Égalité • Fraternité
RÉPUBLIQUE FRANÇAISE

AMBASSADE DE FRANCE
EN ALBANIE

THIRRJE PËR KANDIDATURA

Ambasada e Francës në Shqipëri kërkon të punësojë **<u>një punonjës(e) shërbimi me kohë të pjesshme.</u>**
Data e fillimit të punës parashikohet sa më shpejt të jetë e mundur.

<u>Detyrat nën autoritetin e shefit të postit:</u>

- Të kujdeset për mirëmbajtjen e përditshme të rezidencës së Francës: hapësirat e pritjes (salloni, dhoma e ngrënies), hapësirat private dhe hapësirën e shërbimit (kuzhina).
- Veprimtari plotësuese: në rast nevoje, të ndihmojë në organizimin e pritjeve (përgatitja e shërbimit, shtrimi i tavolinave, organizimi i pritjeve).

<u>Kompetencat e nevojshme:</u>

- Preferohet të ketë përvojë si punonjës(e) shërbimi ose si sanitar(e)
- Të njohë rregullat e higjenës
- Të ketë njohuri mbi alternativat ekologjike për produktet e mirëmbajtjes
- Të ketë njohuri gjuhësore: shqip dhe/ose frëngjisht

<u>Cilësitë e nevojshme</u>:

- Të ruajë në mënyrë absolute fshehtësinë profesionale dhe të jetë i/e sjellshme
- Të respektojë oraret dhe të jetë i/e gatshme (mundësisht gjatë darkave)
- Të bëjë kujdes në veshje dhe higjienën personale

<u>Kushtet e punës:</u>

- Paga bruto: 38 565 Lekë
- Kontrata sipas legjislacionit shqiptar
- Kohëzgjatja e punës: 20 orë në javë.

Ju lutemi të dërgoni kandidaturën tuaj <u>deri më datën 4 maj 2019</u> (CV dhe letër motivimi në frëngjisht bashkë me letrat e rekomandimit të punëdhënësve të mëparshëm) në adresën e mëposhtme :
helene.marchal@diplomatie.gouv.fr

Ambasada e Francë do të kontaktojë kandidatët e përzgjedhur për një takim dhe më pas për t'u vënë në provë nga ana profesionale.